



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA E TIRANËS
AGJENCIA E PARQEVË DHE REKREACIONIT
NJËSIA E PROKURIMIT PUBLIK

Nr. _____ prot.

Tiranë më, _____, _____, 2023

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)

Data 13.12.2023

Drejtuar: **“BOE “ASI-2A CO” Shpk & “2Z KONSTRUKSION” Shpk** .

Procedura e prokurimit/lotit: **“Procedure E Hapur**

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **REF-78199-08-23-2023**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **“Ndërtim Objekt Shërbimi, Sistem Vaditës dhe rrethim tek Piste e Vrapit në Pmlat”**

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini Nr.73, datë 28 Gusht 2023

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. BOE “ASI-2A CO” Shpk me Nipt K53002402C dhe “2Z KONSTRUKSION” Shpk me Nipt J63229466K

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera: **27 001 270.28** (njëzetë e shtatë milion e një mijë e dyqind e shtatëdhjetë pikë njëzet e tetë) **lekë pa Tvsh**

2. BOE “LIQENI VII” Shpk me Nipt K01730502W dhe “SARDO” Shpk me Nipt K13120402W

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera: **27 182 766.45** (njëzet e shtatë milion e njëqind e tetëdhjetë e dy mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë pikë dyzetë e pesë) **lekë pa Tvsh.**

3. “BE-IS” Shpk

K71412003A

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera: **31 627 898** (tridhjetë e një milion e gjashtëqind e njëzet e shtatë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e tetë) **lekë pa Tvsh.**

4. “ED Konstruksion” Shpk

K61625001I

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera: **29 526 340.73** (njëzet e nëntë milion e pesëqind e njëzet e gjashtë mijë e treqind e dyzet pikë shtatëdhjetë e tre) **lekë pa Tvsh.**

5. BOE “NDËRTIMI” Shpk me Nipt K11325002C dhe “NDREGJONI” Shpk me Nipt K31329048I

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera: **28 070 985** (njëzetë e tetë milion e shtatëdhjetë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e pesë) **lekë pa Tvsh.**

6. “PEPA GROUP” Shpk

L42215009L

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera: **31 560 501.63** (tridhjetë e një milion e pesëqind e gjashtëdhjetë mijë e pesëqind e një pikë gjashtëdhjetë e tre) **lekë pa Tvsh.**

7. BOE “ FLED” Shpk me Nipt K17621104C dhe “Desaret Company” Shpk me Nipt K01816001J

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera: **24 076 331** (njëzetë e katër milion e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e treqind e tridhjetë e një) **lekë pa Tvsh.**

8. BOE “AL-MEXWOOD” Shpk me Nipt K36603807B dhe “Beqiri” Shpk me Nipt J98624801V

Emri i plotë i shoqërisë

umri i NIPT-t

Vlera: **34 379 553** (tridhjetë e katër milion e treqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e tre) **lekë pa Tvsh**. Nuk ka pasur tërheqje apo modifikim ofertash nga kjo shoqëri.

9. “Leon Konstruksion” Shpk

K71820009I

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera: **31 560 501.63** (tridhjetë e një milion e pesëqind e gjashtëdhjetë mijë e pesëqind e një pikë gjashtëdhjetë e tre) **lekë pa Tvsh**.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. BOE “ FLED” Shpk me Nipt K17621104C dhe “Desaret Company” Shpk me Nipt K01816001J

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Arsyet e mëposhtme:

Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur dokumentat si më poshtë:

1. Në kriteret e veçanta të kualifikimit pika 2.3.4 është kërkuar :

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë fuqi punëtore minimalisht **45 (dyzete e pese) persona**. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve për periudhën maj 2023-korrik 2023, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8.

Operatori ekonomik krahas deklaratës, duhet të dorëzojë dokumentacionin si më poshtë:

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj;
- Listë pagesat e punonjësve, të konfirmuara nga institucionet përkatëse sipas formatit që kërkohet nga legjislati në fuqi.

Nga verifikimi i Formularit Përmbledhës të Vetdeklarimit konstatohet se operatori ekonomik FLED shpk nuk ka deklaruar në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit numrin minimal të punonjësve të disponueshëm me qëllim verifikimin nga autoriteti kontraktor nëse operatori ekonomik plotëson këtë kriter në raport me përqindjen e pjesëmarrjes në bashkim.

2. Në Kriteret e Veçanta për Kualifikim, Kapaciteti Ekonomik dhe financiar pika 2.3.7 përcaktohet:

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar si staf teknik punonjësit specialistë të kualifikuar ne profilet përkatëse si më poshtë

- Teknik Ndertimi 2 (dy)
- Teknik Topograf/gjeodet 1 (nje)
- Hidraulik 2(dy)
- Karpentiere 2(dy)
- Pllakashtrues 2(dy)
- Hekurkthyes 2(dy)
- Mekanik 2(dy)
- Elektracist 2(dy)
- Murator 2(dy)
- Saldator 2(dy)
- Bojaxhi 2(dy)
- Hidroizolues 2(dy)
- Manovrator 3 (tre)
- Punonjës/specialist duralumini 2 (dy)
- Punonjes /Specialist Gipsi 2 (dy)

Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqiten:

- Kontratat e punës individuale (të vlefshme).
- Diploma për formimin profesional (të vlefshme), të cilat duhet të jenë të lëshuara nga institucione publike/private të licensuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”, i ndryshuar, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqerise per periudhen maj 2023-korrik 2023”, sipas Ligjit Nr. 8734, datë 01.02.2001 dhe Ligji Nr. 13/2013.

Për teknikun e ndërtimit dhe teknikun topograf të paraqiten edhe diplomat e shkollës së mesme profesionale ose licencat përkatëse Per profesionet si me sipër, operatori ekonomik duhet te plotesoje tabelën si me poshtë:

Nr.	Emer Mbiemer i punonjesit	Profesioni	Institucioni publik/privat leshues i certifikates/diplomes	Nr NIPT (Ne rast se leshuesi eshte institucion privat)
1				
2				
3..				

-Për manovratorët të paraqitet kontrata e punes dhe dëshmia e aftësisë profesionale lëshuar nga DPSHTRR **Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit**

Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojces Nr. 8, të DST-ve dhe në zbatim të V.K.M – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 26 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, pika 6 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, si më sipër kërkuar.

Nga verifikimi i dokumentacionit të operatorëve ekonomik konstatohet se:

Operatori ekonomik FLED shpk ka deklaruar në formularin përmbledhës të vetdeklarimit 1 punonjës hidroizolues Z.Ervis Mara ndërsa operatori ekonomik Desaret Company shpk nuk ka deklaruar punonjës hidroizolues. Pra bashkimi i operatorëve ekonomik ka deklaruar vetëm një punonjës hidroizolues nga 2 të kërkuar duke mos plotësuar në tërësi kriterin sa më sipër përcaktuar nga autoriteti kontraktor.

Gjithashtu operatori ekonomik FLED shpk në përmbushje të pikës 2.3.7 ka deklaruar në formularin përmbledhës së vetëdeklarimit Z.E.M Specialist Duralumini pajisur me çertifikatë kualifikimi RE/BORN L71309019P dhe z.L.K Specialist Duralumini pajisur me çertifikatë kualifikimi RE/BORN L71309019P. OE nuk plotëson pikën 2.3.7 pasi nuk ka paraqitur 2 (dy) Punonjës/specialist duralumini të pajisur me Diploma për formimin profesional (të vlefshme), të cilat duhet të jenë të lëshuara nga institucione publike/private të licensuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”, Subjekti RE/BORN L71309019P nuk është i pajisur me License formimi profesional për të ofruar kurset e trajnimit specialist duralumini. **Këtë qëndrim ka mbajtur dhe KPP-ja në vendimin nr. 745/2022 në lidhje me dëshmitë e lëshuara nga subjekte të pa licensuara.**

Po në plotësim të kësaj pike operatori ekonomik FLED shpk në përmbushje të pikës 2.3.7 ka deklaruar në formularin përmbledhës së vetëdeklarimit Z.E.S punonjës Elektrik pajisur me çertifikatë kualifikimi RE/BORN L71309019P. OE nuk plotëson pikën 2.3.7 pasi nuk ka paraqitur Elektracist 1(një) të pajisur me Diploma për formimin profesional (të vlefshme), të cilat duhet të jenë të lëshuara nga institucione publike/private të licensuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”, Subjekti RE/BORN L71309019P nuk është i pajisur me License formimi profesional për të ofruar kurset e trajnimit punonjës elektriciste. **Këtë qëndrim ka mbajtur edhe KPP në vendimin nr. 745/2022 në lidhje me dëshmitë e lëshuara nga subjekte të pa licensuara.**

3. Në kriteret e përgjithshme të kualifikimit përcaktohet se nëse oferta paraqitet nga një Bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

Referuar aktmarrëveshjes së bashkëpunimit datë 12.09.2023 palët kanë rënë dakort të realizojnë punimet përkatësisht FLED shpk 85 % të zërave dhe volumeve të preventivit dhe OE shoqwrria “Desaret Company” shpk 15% të zërave dhe volumeve të preventivit. Përkatësisht OE shoqwrria “Desaret Company” shpk ka marrë përsipër të realizojë sipas preventivit bashkëlidhur

aktmarrëveshjes “Punime hekuri” F.V hekur betoni periodik fi6-10mm 50%, F.V Hekur betoni periodik fi>10 mm 50 %, Konstruksione metalike të thjeshta 50%, Kangjella metalike dekorative 50%, Në formularin përmbledhës të vëtedeklarimit OE shoqëria “Desaret Company” shpk nuk ka deklaruar punonjës Hekurkthyes 2(dy) dhe punonjës Saldator 2(dy) në raport me punimet të cilat ka marrë përsipër të kryejë. Shoqëria OE shoqëria “Desaret Company” shpk ka marrë përsipër të realizojë sipas preventivit bashkëlidhur aktmarrëveshjes Punime shtresash përkatësisht Shtresë me pllaka grez porcelanato 50% dhe veshje me pllakë majolike 50% në formularin përmbledhës të vëtedeklarimit OE shoqëria “Desaret Company” shpk nuk ka deklaruar punonjës pllakashtrues në raport me punimet të cilat ka marrë përsipër të kryejë. Rrjedhimisht OE shoqëria “Desaret Company” shpk nuk plotëson kapacitetet e deklaruara në raport me natyrën e punimeve që ka marrë përsipër të realizojë referuar marrëveshjes së bashkepunimit.

4. Në kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti teknik, pika 2.3.9, kërkohet specifikisht:

*2.3.9 Operatori ekonomik te disponojë ose te kete me kontrate sherbimi license lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për grumbullim dhe transportim të Inerteve **Kodi III.2.B shoqeruar me aktin e miratimit.***

Shoqëritë e huaja duhet te kene kryer ekuivalentimin (njehsimin) e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Transportit dhe Infrastruktures, Republika e Shqipërisë, sic percaktohet ne *Rregulloren për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, e miratuar me VKM Nr.42, date 16.01.2008.*

Kjo License duhet per grumbullimin, transportimin dhe ruajtjen e mbetjeve te dale gjate punimeve te ndryshme te ndertimit.

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatorët ekonomik konstatohet se OE “Desaret Company” shpk ka marrë përsipër në marrëveshjen e bashkëpunimit të realizojë transport të mbetjeve inerte ka paraqitur liçensë lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për grumbullim dhe transportim të Inerteve Kodi III.2.B por nuk ka paraqitur aktin e miratimit të lejes sikundër specifikisht kërkuar në Kriterin sipas pikës 2.3.9.

5. Në kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti teknik, pika 2.3.11 kërkohet specifikisht:

2.3.11 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

Në përputhje me specifikimet teknike si dhe preventivit përkatës,operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim /kontrate bashkëpunimi nga prodhuesi/distributori,me të cilin prodhuesi /distributori autorizon kompaninë pjesëmarrëse në procedurë të ofertojë këto pajisje mallra në këtë procedurë prokurimi si më poshtë :

-Hekur;

-Pajisje elektrike

-Pajisje hidraulike;

-Dyer & dritare

-Materiale hidroizoluese

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër ,ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime ,në përputhje me nenin 26, pika 7,të VKM nr .285 datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur konstatohet se per pajisjet elektrike operatori ekonomik ka paraqitur autorizim distributori nga Sali Elektrik i cili është fotokopje. Ne dokumentat e tenderit eshte percaktuar:

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Sa më sipër dokumentacioni nuk është paraqitur konform përcaktimit në dokumentat e tenderit duke mos u konsideruar i vlefshëm.

2. “PEPA GROUP” Shpk

L42215009L

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Arsyet e mëposhtme:

Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur dokumentat si më poshtë:

1. Ne kriteret e vecanta te kualifikimit, kapaciteti teknik pika 2.3.7 eshte kërkuar :

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar si staf teknik punonjesit specialistë të kualifikuar në profilet përkatëse si më poshtë:

- Teknik Ndertimi 2 (dy)
- Teknik Topograf/gjeodet 1 (nje)
- Hidraulik 2(dy)
- Karpentiere 2(dy)
- Pllakashtrues 2(dy)
- Hekurkthyes 2(dy)
- Mekanik 2(dy)
- Elektracist 2(dy)
- Murator 2(dy)
- Saldator 2(dy)
- Bojaxhi 2(dy)
- Hidroizolues 2(dy)
- Manovrator 3 (tre)
- Punonjës/specialist duralumini 2 (dy)
- Punonjes /Specialist Gipsi 2 (dy)

Për punonjësit e mësipërm duhet te paraqiten:

- Kontratat e punës individuale (të vlefshme).
 - **Diploma për formimin profesional (të vlefshme), të cilat duhet të jenë të lëshuara nga institucione publike/private të licensuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”, i ndryshuar, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për periudhën maj 2023-korrik 2023”, sipas Ligjit Nr. 8734, datë 01.02.2001 dhe Ligji Nr. 13/2013.**
- Referuar formularit përmbledhës së vetëdeklarimit në përmbushje të pikës 2.3.7 OE ka deklaruar Z.S.H punonjës/specialist duralumini dhe - Z.M.J punonjës/specialist duralumini të pajisur me çertifikata kualifikimi lëshuar nga Agjencia Shqiptare e Punësimit L21410066G. OE nuk plotëson pikën 2.3.7 pasi nuk ka paraqitur 2 (dy) Punonjës/specialist duralumini të pajisur me Diploma për formimin profesional (të vlefshme), të cilat duhet të jenë të lëshuara nga institucione publike/private të licensuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”, Subjekti Agjencia Shqiptare e Punësimit L21410066G nuk është i pajisur me Liçensë formimi profesional për të ofruar kurset e trajnimit specialist duralumini.
 - OE nuk plotëson pikën 2.3.7 pasi nuk ka paraqitur punonjës mekanik kjo pasi ka paraqitur L.S Mekanik pajisur me çertifikatë trajnimi lëshuar nga Agjencia Shqiptare e Punësimit L21410066G dhe L.I.S Mekanik Agjencia Shqiptare e Punësimit L21410066G.
Këtë qëndrim ka mbajtur dhe KPP në vendimin nr. 745/2022 në lidhje me dëshmitë e lëshuara nga subjekte të pa licensuara.

OE ka deklaruar se janë të pajisur me Diplomë/Çertifikatë lëshuar nga “Agjencia Shqiptare e Punësimit” me NIUS L21410066G. Nga verifikimi i kryer në faqen zyrtare www.qkb.gov.al, në seksionin “Kërko për Licencë”, shoqëria si më sipër është licensuar me licensën me nr. LN-5883-11- 2012 me Titull “Formim profesional”, për të cilën figurojnë dy miratime nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, dhe nga QKB: - Me vendimin nr. 2471 prot., datë: 20. 11. 2012, i është miratuar nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. - Me proces-verbalin nr. 11467, datë: 22. 12. 2016, i është miratuar në heshtje kërkesa për shtimin e profesioneve. Në këto dy miratime, rezulton se shoqëria “Agjencia Shqiptare e Punësimit”, me NIUS L21410066G, është licensuar për formimin e kurseve profesionale të ndryshme, por jo për ofrimin e kurseve profesionale sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në RSH”, për personat e kërkuar në DST. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga ky ofertues rezulton se për punonjësit e kualifikuar ka deklaruar se janë të pajisur me dëshmi profesionale nga Agjencia Shqiptare e Punësimit, me NUIS L21410066G. Për sa i përket subjektit Agjencia Shqiptare e Punësimit (A.SH.P.), me NUIS L21410066G, rezulton se ky subjekt disponon licencën LN-5883-11-2012 datë 20.11.2012 (miratuar nga Ministria përgjegjëse ose miratim në heshtje) për kurset: Anglisht, Gjermanisht, Italisht, Spanjisht, Greqisht, Arabisht, TOELF, IELTS, CELI, Programe kompjuterike bazë, në Ekonomi/Financë dhe Grafikë, Menaxhim turizmi, Siguria dhe shëndeti në punë, Kuzhinier, Banakier, Kamerier, Parukier, Estetikë, Berber, Picajol, Kasap, Furrtar, Saldator, Marangoz, Pastiçeri, Siguria në kantier, Montator për mjetet e rënda, Rrobaqepës, Elektro-shtëpiake si dhe shtimin e kurseve të formimit profesional: kuzhinë, banakier, kamerier, parukier, estetik, berber, picajol, menaxhim turizmi, kasap,

furrta, saldator, marangoz, pastičier, siguria në kantier, manovrator për mjetet e rënda, rrobaqepës, elektro-shtëpiake, siguria dhe shëndeti në punë, punës dekorative në gur. Për sa më sipër rezulton se ky subjekt (ASHP) referuar Qendrës Kombëtare të Biznesit, rezulton se subjekti “Agjencia Shqiptare e Punësimit” SHPK me NUIS L21410066G dhe Licencë me Nr. LN-5883-11-2012, nuk është i licencuar të ofrojë kurse të formimit profesional dhe të lëshojë certifikata/diploma për profesionet “Punime dualumini”, “Mekanike” sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” dhe nuk ka licencë aktive për kurse të formimit profesional për “Punime dualumini”, “Mekanike” dhe për rrjedhojë, nuk përmbushet kërkesa për kualifikim që dëshmitë e kualifikimit profesional/certifikatë/diploma, të jenë të lëshuara nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh

Sa më sipër dokumentacioni nuk është paraqitur konform përcaktimit në dokumentat e tenderit duke mos u konsideruar i vlefshëm.

3. BOE “NDËRTIMI” Shpk me Nipt K11325002C dhe “NDREGJONI” Shpk me Nipt K31329048I

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Arsyet e mëposhtme:

Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur dokumentat si më poshtë:

1. Në dokumentat e tenderit shtojca 12 “Kriteret e vecanta të kualifikimit” pika 2.3.14 përcaktohet se: Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe paisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës. Eskavator me goma 2 copë.

Në plotësim të këtij kriteri operatori ekonomik Ndërtimi shpk nuk ka deklaruar mjete në pronësi por ka deklaruar me kontrate qeraje mjetet sa më poshtë:

- Eskavator me Goma ADMT 94 me kontratë qeraje Nr.276 Rep, Nr.173 Kol me afat 10.01.2023-09.01.2025
- Eskavator me Goma AKMT 53 me kontratë qeraje Nr.368 Rep, Nr.301 Kol me afat 04.08.2023deri ne përfundimin e kontratës.

Dhe nga operatori ekonomik “Ndregjoni” shpk si anëtar i bashkimit të operatorëve ekonomik në këtë procedurë prokurimi nuk janë deklaruar në Formularin Përmbledhës të vetdeklarimit mjete Eskavator me goma.

Gjate shqyrtimit në tërësi të dokumentacionit të deklaruar nga operatorët ekonomik për makineritë komisioni i vlerësimit të ofertave konstaton se mjete me targa njohjeje ADMT 94 është deklaruar e obliguar në të njëjtën kohë dhe në kontratë tjetër qeraje, konkretisht:

1. Eskavator me goma ADMT 94 i deklaruar nga operatori ekonomik Ed Konstruksion shpk në dispozicion të autoritetit kontraktor në funksion të realizimit të kësaj kontrate me kontratë qeraje Nr.1852 Rep, Nr.568 Kol me afat 02.06.2022- 02.06.2024.

Mjeti me targa njohje sa më sipër të cilët deklarohen me kontrata qeraje në të njëjtën kohë dhe për të njëjtin objekt kontrate, nuk janë të vlefshëm dhe nuk përmbushin kapacitetin teknik për asnjë nga operatorët ekonomik të cilët i kanë deklaruar , argumentuar kjo sa më poshtë:

Referuar dispozitave të Ligjit nr.7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), Kreu V “Kontratat” dhe Kreu VI “Qiraja”, është përcaktuar qartë se Kontrata është veprimi juridik me anë të së cilës një ose disa palë krijojnë, **ndryshojnë ose shuajnë një marrëdhënie juridike, Kontrata është me detyrime të dyanshme, kur palët detyrohen reciprokisht ndaj njëra-tjetrës, Objekti i kontratës duhet të jetë i mundshëm, i ligjshëm, i caktueshëm ose që mund të përcaktohet. Qiraja është kontrata me të cilën njëra palë (qiradhënësi) detyrohet t’i japë palës tjetër (qiramarrësit) një send të caktuar, në gëzim të përkohshëm kundrejt një shpërblimi të caktuar.**

Pra sa më sipërcituar dhe në kuptim të dispozitave ligjore kontrata dhe konkretisht kontrata e qirasë në rastin e mjeteve është një akt midis palëve me një objekt të mundshëm të ligjshëm dhe të caktueshëm, që krijon pasoja juridike ndërmjet dy palëve qiradhënësi dhe qiramarrësi.

Nga konstatimet ka rezultuar se për të njëjtin objekt (Eskavator me goma) janë lidhur dy kontrata qiraje brenda të njëjtit afat kohor, por me palë të ndryshme. Pra i njëjti mjet deklarohet se do te jepet me qera në të njëjtën kohë sipas kontratave përkatëse në palë të ndryshme.

Referuar Kodit Civil një kontrate ka një objekt i cili i përket vetëm asaj kontrate, dhe krijon marrëdhënie e pasoja juridike në përmbushje të asaj kontrate, e të atyre palëve që e nënshkruajnë atë, e absolutisht jo paralelisht në një kontratë tjetër me palë të tjera për të njëjtin objekt. Objekti duhet të jetë i mundshëm (mjeti ADMT 94), i ligjshëm (sipas rregullave të Kodit Rrugor) i caktueshëm (targa e mjetit/ numër shasie/numër leje qarkullimi).

Akte të tilla (kontratat e qerasë sa më sipër) vinë në kundërshtim me KC të RSH dhe përcaktimet ligjore të tij, duke bërë që asnjë nga kontratat të mos konsiderohet e vlefshme dhe si rrjedhojë as kapaciteti teknik përkatësisht për mjetet e paraqitura në dispozicion të autoritetit kontraktor nga dy operatorë ekonomik njëkohësisht konkretisht mjeti me targa ADMT 94 të mos konsiderohet i vlefshëm dhe në përmbushje të kapacitetit teknik nga komisioni i vlerësimit të ofertave.

Sa më sipër operatori ekonomik nuk plotëson kriterin mbi paraqitjen e eskavatorëve me goma 2 copë pasi vetem njëri nga mjetet është i vlefshëm.

- a) ***Në dokumentat e tenderit shtojca 12 “Kriteret e vecanta të kualifikimit” pika 2.3.14 përcaktohet se: Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe paisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës. Autobetoniere 2 copë.***

Në plotësim të këtij kriteri operatori ekonomik Ndërtimi shpk ka nuk ka deklaruar mjete në pronësi por ka deklaruar me kontrate qeraje mjetin sa më poshtë:

- Autobetoniere AA 974 XT me kontratë qeraje Nr.9467 Rep, Nr.6275 Kol me afat 29.09.2022-27.05.2025.

Dhe nga operatori ekonomik “Ndregjoni” shpk si anëtar i bashkimit të operatorëve ekonomik në këtë procedurë prokurimi nuk janë deklaruar mjet autobetonierë në pronësi por janë deklaruar në Formularin Përmbledhës të vetdeklarimit mjete Autobetonierë sa më poshtë:

- Autobetoniere TR 6489 N me kontratë qeraje Nr.342 Rep, Nr.219 Kol me afat 11.01.2023-11.01.2025.

Gjate shqyrtimit në tërësi të dokumentacionit të deklaruar nga operatorët ekonomik për makineritë komisioni i vlerësimit të ofertave konstaton se mjeti me targa njohjeje TR 6489 N është deklaruar e obliguara në të njëjtën kohë dhe në kontratë tjetër qeraje, konkretisht:

1. Autobetonierë TR 6489 N i deklaruar nga operatori ekonomik Ed Konstruksion shpk në dispozicion të autoritetit kontraktor në funksion të realizimit të kësaj kontrate me kontratë qeraje Nr.4665 Rep, Nr.1956 Kol me afat 30.11.2022- 29.11.2024.

Mjetet me targa njohje sa më sipër të cilët deklarohet me kontrata qeraje në të njëjtën kohë dhe për të njëjtin objekt kontrate, nuk janë të vlefshëm dhe nuk përmbushin kapacitetin teknik për asnjë nga operatorët ekonomik të cilët i kanë deklaruar, argumentuar kjo sa më poshtë:

Referuar dispozitave të Ligjit nr.7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), Kreu V “Kontratat” dhe Kreu VI “Qiraja”, është përcaktuar qartë se **Kontrata është veprimi juridik me anë të së cilës një ose disa palë krijojnë, ndryshojnë ose shuajnë një marrëdhënie juridike, Kontrata është me detyrime të dyanshme, kur palët detyrohen reciprokisht ndaj njëra-tjetrës, Objekti i kontratës duhet të jetë i mundshëm, i ligjshëm, i caktueshëm ose që mund të përcaktohet. Qiraja është kontrata me të cilën njëra palë (qiradhënësi) detyrohet t’i japë palës tjetër (qiramarrësit) një send të caktuar, në gëzim të përkohshëm kundrejt një shpërblimi të caktuar.**

Pra sa më sipërcituar dhe në kuptim të dispozitave ligjore kontrata dhe konkretisht kontrata e qirasë në rastin e mjeteve është një akt midis palëve me një objekt të mundshëm të ligjshëm dhe të caktueshëm, që krijon pasoja juridike ndërmjet dy palëve qiradhënësi dhe qiramarrësi.

Nga konstatimet ka rezultuar se për të njëjtin objekt (Autobetonierë) janë lidhur dy kontrata qiraje brenda të njëjtit afat kohor, por me palë të ndryshme. Pra i njëjti mjet deklarohet se do te jepet me qera në të njëjtën kohë sipas kontratave përkatëse në palë të ndryshme.

Referuar Kodit Civil një kontrate ka një objekt i cili i përket vetëm asaj kontrate, dhe krijon marrëdhënie e pasoja juridike në përmbushje të asaj kontrate, e të atyre palëve që e nënshkruajnë atë, e absolutisht jo paralelisht në një kontratë tjetër me palë të tjera për të njëjtin objekt. Objekti duhet të jetë i mundshëm (mjeti TR 6489 N), i ligjshëm (sipas rregullave të Kodit Rrugor) i caktueshëm (targa e mjetit/ numër shasie/numër leje qarkullimi).

Akte të tilla (kontratat e qerasë sa më sipër) vinë në kundërshtim me KC të RSH dhe përcaktimet ligjore të tij, duke bërë që asnjë nga kontratat të mos konsiderohet e vlefshme dhe si rrjedhojë as kapaciteti teknik përkatësisht për mjetet e paraqitura në dispozicion të autoritetit kontraktor nga dy operatorë ekonomik njëkohësisht konkretisht mjeti me targa TR6489N të mos konsiderohet i vlefshëm dhe në përmbushje të kapacitetit teknik nga komisioni i vlerësimit të ofertave.

Sa më sipër bashkimi i operatorëve ekonomik nuk plotëson kriterin mbi paraqitjen e eskavatorëve me goma 2 cope pasi vetëm njëri nga mjetet është i vlefshëm dhe gjithashtu nuk plotëson kriterin për paraqitjen e mjeteve Autobetonierë 2 copë pasi vetëm njëri nga mjetet konsiderohet i vlefshëm duke mos plotësuar kriteret e veçanta për kualifikim, kapaciteti teknik pikat 2.3.10/7 dhe 2.3.10/12.

2. Në dokumentat e tenderit shtojca 12 “Kriteret e vecanta të kualifikimit” pika 2.3.8 ndër të tjera përcaktohet se:

2.3.8 Operatori ekonomik ofertues duhet disponojë punonjës të specializuar/kualifikuar si më poshtë:

- Operatorët ekonomik të kenë në stafin e tyre **1 (një)** punonjes të pajisur me certifikatë “*Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave*”, e cila të jetë e lëshuar nga shoqëritë e akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Për këtë duhet të paraqitet certifikata e trajnimit, e dhënë nga një organizem i licënsuar, shqiptar ose i huaj, si edhe të figurojë në listpagesen e shoqërisë për periudhën maj 2023-korrik 2023.

Nga verifikimi i Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit konstatohet se asnjë nga operatorët ekonomikë anëtarë të bashkimit të operatorëve ekonomik “Ndërtimi” shpk & “Ndregjoni” shpk nuk kanë deklaruar punonjës “*Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave*” duke mos plotësuar Kriteret e vecanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik pika 2.3.8.

Sa më sipër dokumentacioni nuk është paraqitur konform përcaktimit në dokumentat e tenderit duke mos u konsideruar i vlefshëm.

4. “ED Konstruksion” Shpk

K61625001I

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Arsyet e mëposhtme:

Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur dokumentat si më poshtë:

- 1. Në dokumentat e tenderit shtojca 12 “Kriteret e vecanta të kualifikimit” pika 2.3.14 përcaktohet se: Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe paisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës. Eskavator me goma 2 copë.**

Në plotësim të këtij kriteri operatori ekonomik ED Konstruksion shpk ka deklaruar mjete në pronësi

- Eskavator me Goma AIMT 56 i deklaruar 2 herë në mjetet e deklaruara në pronësi Dhe gjithashtu ka deklaruar me kontrate qeraje mjetin eskavator me goma sa më poshtë:
- 2. Eskavator me goma ADMT 94 i deklaruar nga operatori ekonomik Ed Konstruksion shpk në dispozicion të autoritetit kontraktor në funksion të realizimit të kësaj kontrate me kontratë qeraje Nr.1852 Rep, Nr.568 Kol me afat 02.06.2022- 02.06.2024

Gjate shqyrtimit në tërësi të dokumentacionit të deklaruar nga operatorët ekonomik për makineritë komisioni i vlerësimit të ofertave konstaton se mjeti me targa njohjeje ADMT 94 është deklaruar e obliguara në të njëjtën kohë dhe në kontratë tjetër qeraje, konkretisht:

- Eskavator me goma ADMT 94 i deklaruar nga operatori ekonomik Ndërtimi shpk në dispozicion të autoritetit kontraktor në funksion të realizimit të kësaj kontrate me kontratë qeraje Nr.276 Rep, Nr.173 Kol me afat 10.01.2023-09.01.2025

Mjeti me targa njohje sa më sipër i cili deklarohet me kontratë qeraje në të njëjtën kohë dhe për të njëjtin objekt kontrate, nuk janë të vlefshëm dhe nuk përmbushin kapacitetin teknik për asnjë nga operatorët ekonomik të cilët i kanë deklaruar , argumentuar kjo sa më poshtë:

Referuar dispozitave të Ligjit nr.7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), Kreu V “Kontratat” dhe Kreu VI “Qiraja”, është përcaktuar qartë se Kontrata është veprimi juridik me anë të së cilës një ose disa palë krijojnë, ndryshojnë ose shuajnë një marrëdhënie juridike, Kontrata është me detyrime të dyanshme, kur palët detyrohen reciprokisht ndaj njëra-tjetrës, Objekti i kontratës duhet të jetë i mundshëm, i ligjshëm, i caktueshëm ose që mund të përcaktohet. Qiraja është kontrata me të cilën njëra palë (qiradhënësi) detyrohet t’i japë palës tjetër (qiramarrësit) një send të caktuar, në gëzim të përkohshëm kundrejt një shpërblimi të caktuar.

Pra sa më sipërcituar dhe në kuptim të dispozitave ligjore kontrata dhe konkretisht kontrata e qirasë në rastin e mjeteve është një akt midis palëve me një objekt të mundshëm të ligjshëm dhe të caktueshëm, që krijon pasoja juridike ndërmjet dy palëve qiradhënësi dhe qiramarrësi.

Nga konstatimet ka rezultuar se për të njëjtin objekt (Eskavator me goma) janë lidhur dy kontrata qiraje brenda të njëjtit afat kohor, por me palë të ndryshme. Pra i njëjti mjet deklarohet se do të jepet me qera në të njëjtën kohë sipas kontratave përkatëse në palë të ndryshme.

Referuar Kodit Civil një kontrate ka një objekt i cili i përket vetëm asaj kontrate, dhe krijon marrëdhënie e pasoja juridike në përmbushje të asaj kontrate, e te atyre palëve që e nënshkruajnë atë, e absolutisht jo paralelisht në një kontratë tjetër me palë të tjera për të njëjtin objekt. Objekti duhet të jetë i mundshëm (mjeti ADMT 94), i ligjshëm (sipas rregullave të Kodit Rrugor) i caktueshëm (targa e mjetit/ numër shasie/numër leje qarkullimi).

Akte të tilla (kontratat e qerasë sa më sipër) vinë në kundërshtim me KC të RSH dhe përcaktimet ligjore të tij, duke bërë që asnjë nga kontratat të mos konsiderohet e vlefshme dhe si rrjedhojë as kapaciteti teknik perkatesisht për mjetet e paraqitura në dispozicion të autoritetit kontraktor nga dy operatorë ekonomik njëkohësisht konkretisht mjeti me targa ADMT 94 të mos konsiderohet i vlefshëm dhe në përmbushje të kapacitetit teknik nga komisioni i vlerësimit të ofertave.

Sa më sipër operatori ekonomik “ED Konstruksion” shpk nuk plotëson numrin e eskavatorëve me goma të kërkuar nga autoriteti kontraktor duke mos plotësuar kriteret e veçanta për kualifikim, kapaciteti teknik pika pikat 2.3.10/7.

Sa më sipër dokumentacioni nuk është paraqitur konform përcaktimit në dokumentat e tenderit duke mos u konsideruar i vlefshëm.

5. “Leon Konstruksion” Shpk

K71820009I

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Arsyet e mëposhtme:

Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur dokumentat si më poshtë:

Në plotësim të këtij kriteri operatori ekonomik “Leon Konstruksion” shpk ka paraqitur Eskavator me goma me targa AA904JA ka deklaruar me kontrate qeraje mjetet sa më poshtë:

- Eskavator me Goma AA904JA me kontratë qeraje Nr.664 Rep, Nr.220 Kol me afat 11.02.2022-10.02.2027

Gjithashtu mjetin me targa AA904JA me kontratë qeraje Nr.664 Rep, Nr.220 Kol me afat 11.02.2022-10.02.2027 e ka deklaruar edhe Fadromë me goma.

Pra të njëjtin mjet e ka deklaruar në plotësim të kriterit 2.3.10 pika 6 dhe 2.3.10 pika 7. Mjeti do të konsiderohet i vlefshëm vetëm për plotësimin e njëres nga pikat dhe ndodhur në këto kushte operatori nuk plotëson pikën tjetër të kriterit.

Gjithashtu në plotësimin e kriterit për Eskavatorë me goma copë 2 operatori ekonomik ka paraqitur mjetin me targa AA 904 AJ që e konsideruam fadromë me goma dhe mjetin Eskavator me goma Kobelco pa deklaruar targë me kontrate qeraje Nr.614 Rep, Nr.200 Kol.

Referuar kërkesës së përcaktuar në dokumentat e tenderit është qartësisht e kuptueshme se autoriteti kontraktor ka kërkuar mjete vetlëvizëse/ që qarkullojnë në rrugë duke përcaktuar Eskavator me goma për këtë mjet dhe jo mjete që kryejnë punime vetëm brenda kantierit të cilat nuk plotësojnë kërkesën për lëvizshmëri duke mos kryer funksionin për të cilin janë kërkuar nga autoritetit kontraktor.

Bëjmë me dije se në ligjin nr.8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenin 58, pika 1, parashikohet:

“1. Makinat teknologjike janë makina vetëlëvizëse ose që tërhiqen, me rrota ose me zinxhirë. Këto makina janë të destinuara të operojnë mbi rrugë dhe në kantiere dhe mund të jenë të pajisura me mekanizma specialë. Këto mjete mund të lëvizin në rrugë për të kaluar nga një vend pune në tjetrin ose për të zhvendosur sende që lidhen me ciklin e punës së vetë makinës ose të kantierit, sipas kufizimeve dhe mënyrave të përcaktuara nga aktet në zbatim.

2. Sipas qëllimeve të qarkullimit rrugor, makinat teknologjike ndahen në:

a) makina që përdoren për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e veprave ndërtimore a të infrastrukturës rrugore ose për rivendosjen e trafikut;

b) makina që zhbllokojnë rrugën nga bora ose ndihmëse që shpërndajnë rërë a gjëra të këtij lloji; c) motopirunët dhe elektropirunët: mjete të destinuara për lëvizjen e sendeve.”

Ndërsa në nenin 113 pika 2 e këtij ligji parashikohet: “2. Për të qarkulluar në rrugë makinat teknologjike duhen regjistruar në zyrat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, që i lëshojnë lejen e qarkullimit atij që vërteton se është pronari i mjetit”.

Në VKM Nr.153 datë 07.04.2000 “Për Miratimin e Rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në nenin 282 “Regjistrimi dhe vendosja e targës e makinave (Neni 113 i Kodit Rrugor)”, pika 1, parashikohet:

1.Makinat, te cilat lejohen të qarkullojnë në rrugë sipas nenit 113 të Kodit Rrugor, duhet të regjistrohen pranë degës së DRShTRr-së rrethit përkatës, që merret me nxjerrjen e lejes se qarkullimit dhe të targës të atij që deklarohet pronar i mjetit.”

Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

Referuar kriterit sa më sipër autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht dhe ka përcaktuar në mënyrë taksative që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën mësipërme të prokurimit duhet të paraqesin vetdeklarimin për mjetin 1 (një) eskavator me goma duke deklaruar dhe dokumentacionin provues që do të dorëzohet për këtë mjet në fazën e dorëzimit të dokumentacionit. Sqarojmë se, autoriteti kontraktor në mënyrë detyruese ka kërkuar dhe ka përcaktuar në kriteret e veçanta të kualifikimit, që mjetet vetëlëvizëse të deklaruar nga operatorët ekonomikë me anë të vetdeklarimit në fazën e dorëzimit të dokumentacionit pranë autoritetit kontraktor të jenë të shoqëruara me dokumentacionin e duhur e të nevojshëm e konkretisht me certifikaten e pronësisë, lejen e qarkullimit, certifikatën e kontrollit teknik si dhe policën e sigurimit të mjetit. Nga verifikimi i vetdeklarimit dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik “Leon Konstruktion” sh.p.k., konstatohet se ky i fundit nuk ka deklaruar targe njohje për mjetin eskavator me goma. Referuar

legjislacionit të fushës përkatëse, si më sipër cituar, konkretisht Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë dhe VKM Nr.153 datë 07.04.2000 “Për Miratimin e Rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, parashikohet se mjetet e mësipërme duhet të regjistrohen në zyrat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor të rrethit përkatës, të cilët lëshojnë lejen e qarkullimit për pronarin e mjetit. Si rrjedhim në kushtet kur nga ana e ligjvënësit është parashikuar pajisja e këtyre mjeteve me leje qarkullimi, duhet të deklarohet dhe dokumentacioni provues për mjetin eskavator me goma. Konstatojmë se deklarimi dhe informacioni i dhënë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit nga ana e operatorit ekonomik nuk është i saktë sikundër kërkuar nga autoriteti kontraktor për këto mjete, duke mos e përmbushur kështu kriterin e përcaktuar në dokumentat e tenderit ku ky mjet (mjet që qarkullon në rrugë) duhet të jetë i pajisur me targa njohjeje të cilat në këtë fazë duhet të deklaroheshin nga operatori ekonomik referuar akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi si dhe kërkesës së autoritetit kontraktor dhe përpara shpalljes së njoftimit të fituesit duhej të paraqitej dokumentacioni provues për mjetet që shënohen në regjistra publikë.

Në përfundim komisioni i vlerësimit të ofertave arrin në konkluzionin se nga të dhënat e plotësuara në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit mbi dokumentacionin provues që operatori ekonomik do të paraqesë për këto mjete nuk plotëson kërkesat e kriterëve të kualifikimit për disponimin e mjetit sikundër përcaktuara në dokumentet e tenderit të vendosura nga autoriteti kontraktor dhe konsiderohet i pavlefshëm. Pra sa më sipër operatori ekonomik nuk plotëson kriterin për mjetet eskavator me goma 2 copë përcaktuar në kriteret e veçanta për kualifikim, kapaciteti teknik pika 2.3.10/7.

2. Nga verifikimi i dokumentacionit vërehet parregullsi në vetëdeklarimin e kryer për mjetin TR 6489N pasi 2 operatorë ekonomikë dhe respektivisht operatorët ekonomikë “Leon konstruktion” dhe “Ed Konstruktion” kanë paraqitur mjetin autobetoniere me targa TR 6489 N me kontrate qeraje të njëjtë në numër dhe datë dhe përkatësisht kontrata e qerasë Nr.4665 Rep, Nr 1956 Kol me afat 30.11.2022- 29.11.2024. Pra për dy operatorë ekonomikë të ndryshëm pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi për mjetin me targa TR 6489 N është deklaruar e njëjta kontratë qeraje duke krijuar paqartësi kush nga operatorët ekonomik është qeramarrës i mjetit nëpërmjet kësaj kontrate qeraje.

3. Në kriteret e veçanta për kualifikim, kapaciteti teknik pika 2.3.8 përcaktohet:

2.3.8 Operatori ekonomik ofertues duhet disponojë punonjës të specializuar/kualifikuar si më poshtë:

- Operatorët ekonomik të kenë në stafin e tyre **1 (një)** punonjes të pajisur me çertifikatë “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M-së Nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”. Për këtë duhet të paraqitet çertifikata e trajnimit për “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit për punë”, e dhënë nga një organizem i licensuar, shqiptar ose i huaj, si edhe të figurojë në listpagesen e shoqërisë për periudhën maj 2023-korrik 2023.

Nga verifikimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik “Leon Konstruksion” konstatohet se në Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit ky operator ekonomik nuk ka deklaruar se disponon punonjës të pajisur me çertifikatë “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” duke mos plotësuar kriteret e veçanta për kualifikim kapaciteti teknik, pika 2.3.8.

Sa më sipër dokumentacioni nuk është paraqitur konform përcaktimit në dokumentat e tenderit duke mos u konsideruar i vlefshëm.

6. BOE “AL-MEXWOOD” Shpk me Nipt K36603807B dhe “Beqiri” Shpk me Nipt J98624801V

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Arsyet e mëposhtme:

Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur dokumentat si më poshtë:

1. Ne kriteret e veçanta të kualifikimit pika b është kërkuar :

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

BOE shoqëria “Al Maxwood” dhe shoqëria “Beqiri” ka paraqitur sigurimin e ofertës nga kompania Sigal sha në vlerën 709.188 (shtatëqind e nëntë mijë e njëqind e tetëdhjetë e tetë) lekë.

Në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, Neni 83, pika 2 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 30 pika 3 përcaktohet specifikisht:

“Autoriteti/enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit vlerën e sigurimit të ofertës, e cila është sa 2% e vlerës së fondit limit të kontratës ose lotit”.

Pra vlera e sigurimit të ofertës referuar fondit limit të procedurës është 35.459.428 (tridhjetë e pesë milion e katërqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e katërqind e njëzet e tetë) lek X 2 % = 709.188,56 lek.

Në dokumentat e tenderit Shtojca Njoftimi i Kontratës Seksioni 3, pika 3.1 autoriteti kontraktor ka përcaktuar vlerën e saktë të sigurimit të ofertës sa 2% e vlerës së fondit limit të përcaktuar e cila është **709.188,56 (shtatëqind e nëntë mijë e njëqind e tetëdhjetë e tetë presje pesëdhjetë e gjashtë) leke.**

Pra sa më sipër operatorit ekonomik nuk ka paraqitur vlerën e sigurimit të ofertës referuar akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi si dhe përcaktimit të kryer në dokumentat e tenderit shtojca “Njoftimi i kontratës”.

- Referuar formularit përmbledhës së vetdeklarimit në përmbushje të pikës 2.3.7 OE Shendelli shpk subjekt mbështetës ka deklaruar Z. Ylli Rrapaj punonjës/specialist duralumini dhe - të pajisur me certifikatë kualifikimi lëshuar nga Agjencia Shqiptare e Punësimit L21410066G. OE nuk plotëson pikën 2.3.7 pasi punonjësi Ylli Rrapaj nuk plotëson kushtin Punonjës/specialist duralumini i pajisur me Diplomë për formimin profesional (të vlefshme), të cilat duhet të jenë të lëshuara nga institucione publike/private të licensuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”, Subjekti Agjencia Shqiptare e Punësimit L21410066G nuk është i pajisur me Licensë formimi profesional për të ofruar kurset e trajnimit specialist duralumini.

Këtë qëndrim ka mbajtur dhe KPP në vendimin nr. 745/2022 në lidhje me dëshmitë e lëshuara nga subjekte të pa licensuara.

OE ka deklaruar se janë të pajisur me Diplomë/Çertifikatë lëshuar nga “Agjencia Shqiptare e Punësimit” me NIUS L21410066G. Nga verifikimi i kryer në faqen zyrtare www.qkb.gov.al, në seksionin “Kërko për Licencë”, shoqëria si më sipër është licensuar me licensën me nr. LN-5883-11- 2012 me Titull “Formim profesional”, për të cilën figurojnë dy miratime nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, dhe nga QKB: - Me vendimin nr. 2471 prot., datë: 20. 11. 2012, i është miratuar nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. - Me proces-verbalin nr. 11467, datë: 22. 12. 2016, i është miratuar në heshtje kërkesa për shtimin e profesioneve. Në këto dy miratime, rezulton se shoqëria “Agjencia Shqiptare e Punësimit”, me NIUS L21410066G, është licensuar për formimin e kurseve profesionale të ndryshme, por jo për ofrimin e kurseve profesionale sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në RSH”, për personat e kërkuar në DST. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga ky subjekt mbështetës rezulton se për punonjësin e kualifikuar ka deklaruar se është i pajisur me dëshmi profesionale nga Agjencia Shqiptare e Punësimit, me NUIS L21410066G. Për sa i përket subjektit Agjencia Shqiptare e Punësimit (A.SH.P.), me NUIS L21410066G, rezulton se ky subjekt disponon licensën LN-5883-11-2012 datë 20.11.2012 (miratuar nga Ministria përgjegjëse ose miratim në heshtje) për kurset: Anglisht, Gjermanisht, Italisht, Spanjisht, Greqisht, Arabisht, TOELF, IELTS, CELI, Programe kompjuterike bazë, në Ekonomi/Financë dhe Grafikë, Menaxhim turizmi, Siguria dhe shëndeti në punë, Kuzhinier, Banakier, Kamerier, Parukier, Estetikë, Berber, Picajol, Kasap, Furrтар, Saldator, Marangoz, Pastiçeri, Siguria në kantier, Montator për mjetet e rënda, Rrobaqepës, Elektro-shtëpiake si dhe shtimin e kurseve të formimit profesional: kuzhinë, banakier, kamerier, parukier, estetik, berber, picajol, menaxhim turizmi, kasap, furrtar, saldator, marangoz, pastiçier, siguria në kantier, manovrator për mjetet e rënda, rrobaqepës, elektro-shtëpiake, siguria dhe shëndeti në punë, punës dekorative në gur. Për sa më sipër rezulton se ky subjekt (ASHP) referuar Qendrës Kombëtare të Biznesit, rezulton se subjekti “Agjencia Shqiptare e Punësimit” SHPK me NUIS L21410066G dhe Licencë me Nr. LN-5883-11-2012, nuk është i licensuar të ofrojë kurse të formimit profesional dhe të lëshojë certifikata/diploma për profesionet “Punime dualumini”, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” dhe nuk ka licensë aktive për kurse të formimit profesional për “Punime dualumini”, dhe për rrjedhojë, nuk përmbushet kërkesa për kualifikim që dëshmitë e kualifikimit profesional/certifikatë/diploma, të jenë të lëshuara

nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.

Sa më sipër operatori ekonomik ka vetëm një punonjës specialist duralumini me dokumentacion të rregullt nga 2 të kërkuar.

Sa më sipër dokumentacioni nuk është paraqitur konform përcaktimit në dokumentat e tenderit duke mos u konsideruar i vlefshëm.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë “**BOE “ASI-2A CO” Shpk & “2Z KONSTRUKSION” Shpk, ASI-2A CO Shpk** me adresë: FIER Rruga Skenderbeu, Lagjia Bishanake, pallati nr 18, hyrja nr. 6 ,**2Z KONSTRUKSION Shpk**, me adresë: Fier Roskovec Strum Fshati Suke i siperm, Nr 2, Rruga Strum - Suke, Km 3, Lagjia Zoga. se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **27 001 270.28** (njëzetë e shtatë milion e një mijë e dyqind e shtatëdhjetë pikë njëzet e tetë) **lekë pa Tvsh**, është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë pranë Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit me adresë: Rruga “Xhezmi Delli”,Godina nr.20, Tiranë, me nr kontakti 0675167491 sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se, nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej :**27 182 766.45** (njëzet e shtatë milion e njëqind e tetëdhjetë e dy mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë pikë dyzetë e pesë) **lekë pa Tvsh**, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit te Fituesit (Paraparak)

PO JO X

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë)_____

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO JOX

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë)_____

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Anisa RUSSETI